



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 104/02-31207/24  
Kaçanik, 24.12.2024

Në pajtim me nenin 30 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. Nr. 28/04), të nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal (Gazeta Zyrtare Nr. 7/10 Gusht 2011) të nenit 5.3 e Rregullores së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal, të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-31207/24 prej datës 12.12.2024, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur me 24 dhjetor 2024, mori këtë:

**VENDIM**  
**PËR MIRATIMIN E NISMËS PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL ME**  
**KOMUNËN IZNIK NË BURSA TË TURQISË**

I. Me këtë Vendim, MIRATOHET Nisma e Kryetarit të Komunës Kaçanik 01Nr. 104/02-31207/24 prej datës 12.12.2024, për bashkëpunim Ndër komunal me komunën Iznik në Bursa të Turqisë.

1. Kjo Nismë është iniciuar nga z. Recep Gündüz Koordinator i Qendrës Kulturore, Kosova” në Bursa, që përfaqëson Komunitetin Shqiptar në Bursa.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet ndërmjet Komunës së Kaçanikut dhe Komunës Iznik – Bursa
3. Bashkëpunimi ndër komunal ndërmjet dy komunave do të zhvillohet në fushat si në vijim
  - 3.1 Arsimi dhe Kultura
  - 3.2 Zhvillimi Ekonomik Lokal
  - 3.3 Shërbime Publike dhe Mbrojtja e Ambientit
4. Qëllimi i bashkëpunimit ndër komunal është shkëmbimi i përvojave më të mira ndërmjet Dy Komunave duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat e lartë cekura.
  - 4.1 Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi dhe procedurat e mëtejme, do të kujdesët Kryetari i Komunës.

**Me këtë Vendim njoftohen:** MAPL; Kryetari i Komunës (përmes Zyrës së Kryetarit njoftohet komuna Iznik dhe organet tjera relevante); Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit  
Kemal Murseli



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal of Kaçanik

01Nr. 106/02-31207 /24  
Kaçanik, 12.12.2024

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër komunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër komunal, Kryetari i Komunës paraqet :

**PROPOZIM – VENDIM PËR MIRATIMIN E NISMËS  
PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNËN IZNIK NË BURSA TË  
TURQISË**

1. Kjo nismë është iniciuar nga z. Recep Gündüz Kordinator i Qendrës Kulturore „Kosova” në Bursa , që përfaqëson Komunitetin Shqiptar në Bursa.
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet ndërmjet Komunës së Kaçanikut dhe Komunës Iznik – Bursa
3. Bashkëpunimi ndër komunal ndërmjet dy komunave do të zhvillohet në fushat si në vijim
  - 3.1 . Arsimi dhe Kultura
  - 3.2 . Zhvillimi Ekonomik Lokal
  - 3.3 . Shërbime Publike dhe Mbrojtja e Ambientit
4. Qëllimi i bashkëpunimit ndër komunal është shkëmbimi i përvojave më të mira ndërmjet Dy Komunave duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat e lartë cekura. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik.

**Arsyetim**

z. Recep Gündüz vizitoi komunën tonë më 26.08.2024 dhe shprehu vullnetin dhe iniciativën për të ndërmjetësuar rreth Nismës për Bashkëpunim Ndër komunal në mes të Komunës së Kaçanikut dhe Komunës Iznik në Bursa. Ndërsa, në mes datave 24 dhe 25 Tetor 2024 një delegacion nga Komuna e jonë me koordinimin e z.Gündüz vizitoi Bursan konkretisht Komunën e Iznikut ku takuam udhëheqësit e kësaj komune dhe kryetarin e saj Kagan Mehmet Usta, me të cilët biseduam dhe u dakorduam rreth Nismës për Bashkëpunim Ndër komunal.

